



Numri i lëndës **KSC-BC-2023-10**

Prokurorja e Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës

Vendosi: **Gjykatësja e Procedurës Paraprake**

 Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 12 korrik 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim në Lidhje me Kalendarin e Çështjes

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit

Xhonatan Elistan Ris

Administratores

Fidelma Donlon

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit

Felisiti Geri

Mbrojtjes së Haxhi Shalës

Tobi Kadman

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 39(1) dhe 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 9(5)(a), 95(2)(f) dhe (j), 95(5), dhe 98(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 5 qershor 2024, pas një kërkesë të Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit ("z. Bahtijari" ose "Mbrojtja e Bahtijarit"),² Gjykatësja e Procedurës Paraprake e shtyu afatin e dorëzimit të dosjeve paraprake nga mbrojtja e të gjithë të akuzuarve deri të enjten, 20 qershor 2024, dhe gjithashtu vendosi të caktonte një datë të re paraprake për kalimin e dosjes së çështjes Trupit Gjykues deri të premtën, 5 korrik 2024.³
2. Më 19 qershor 2024, Mbrojtja e Bahtijarit dorëzoi dosjen e saj paraprake.⁴
3. Më 20 qershor 2024, pas një kërkesë konkrete të Mbrojtjes së Sabit Januzit ("z. Januzi" ose "Mbrojtja e Januzit"),⁵ Gjykatësja e Procedurës Paraprake: (i) miratoi një shtyrje të mëtejshme të afatit për dorëzimin e dosjeve paraprake të Mbrojtjes, nëse ka, me shtatë (7) ditë pas njoftimit të vendimit mbi kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") për ndryshimin e aktakuzës kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari ("Kërkesa për Ndryshime"); dhe (ii) udhëzoi Mbrojtjen e Bahtijarit për të paraqitur,

¹ KSC-BC-2023-10, F00327, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake*, 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00310, Mbrojtja e z. Bahtijari, *Parashtrim i Bahtijarit për Shtyrjen e Dorëzimit të Dosjes Paraprake*, 31 maj 2024, publik.

³ KSC-BC-2023-10, F00324, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Bahtijarit për Shtyrje Afati*, 5 qershor 2024, publik.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00343, Mbrojtja e z. Bahtijari, *Dosja Paraprake e Bahtijarit*, 19 qershor 2024, konfidenciale.

⁵ KSC-BC-2023-10, F00340, Mbrojtja e z. Januzi, *Kërkesë e Januzit për Shtyrje të Afatit të Dorëzimit të Dosjes Paraprake*, 17 qershor 2024, publike.

nëse dëshiron, një dosje paraprake të përditësuar, brenda të njëjtit afat kohor të shtyrë; si edhe (iii) caktoi një datë të re paraprake për kalimin e dosjes së çështjes Trupit Gjykses katërmëdhjetë (14) ditë pas njoftimit të vendimit mbi Kërkesën për Ndryshime.⁶

4. Më 8 korrik 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi vendimin mbi Kërkesën për Ndryshime ("Vendimi për Konfirmimin e Ndryshimeve") dhe urdhëroi dorëzimin e aktakuzës së re të përbashkët.⁷ Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu ndryshoi afatin për paraqitjen e parashtrimeve të çdo mocioni paraprak nga Mbrojtja e Januzit dhe Mbrojtja e Bahtijarit.⁸

5. Më 10 korrik 2024, sikundër ishte udhëzuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën të përbashkët ("Aktakuza e Përbashkët").⁹

6. Më 12 korrik 2024 u bënë paraqitjet e tjera të z. Januzi dhe z. Bahtijari.¹⁰ Gjatë seancës, Mbrojtja e Januzit kërkoi që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të shtynte afatin për dorëzimin e dosjes së saj paraprake shtatë ditë pas vendimit përfundimtar për çdo mocion paraprak.¹¹ Duke pasur parasysh se, për shkak të natyrës së saj, seanca u mbajt vetëm në praninë e z. Januzi dhe të z. Bahtijari, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e udhëzoi Mbrojtjen e Januzit të dorëzonte kërkesën e saj me shkrim.¹² Gjithashtu, me kërkesë të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, Mbrojtja e Januzit konfirmoi synimin e vet për të dorëzuar një mocion paraprak sipas rregullës 97 të

⁶ KSC-BC-2023-10, F00345, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Januzit për Shtyrje Afati* ("Vendimi i 20 Qershorit 2024"), 20 qershor 2024, publik, para. 18-20.

⁷ KSC-BC-2023-10, F00377, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë dhe Çështje të Lidhura me Të*, 8 korrik 2024, konfidencial, para. 79(c). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 9 korrik 2024, F00377/RED.

⁸ Vendimi mbi Konfirmimin e Ndryshimeve, para. 79(g).

⁹ KSC-BC-2023-10, F00379, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim nga Prokuroria i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar*, 10 korrik 2024, publik, me Shtojcat 1-2, konfidenciale, dhe Shtojcat 3-4, publike.

¹⁰ KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 12 korrik 2024, publik, f. 262-278.

¹¹ KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 12 korrik 2024, f. 274, rreshtat 19-22; f. 275, rreshti 15 deri në f. 276, rreshti 12. ZPS-ja nuk paraqiti ndonjë konstatim për kërkesën. *Shih* Transkriptin e seancës, 12 korrik 2024, f. 276, rreshtat 20-21.

¹² KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 12 korrik 2024, f. 276, rreshtat 3-25.

Rregullores lidhur me akuzën e re në Aktakuzën e Përbashkët, ndërsa Mbrojtja e Bahtijarit vuri në dukje se ende është e pavendosur.¹³

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Në bazë të nenit 39(1) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka të drejtë të nxjerrë urdhrat apo vendimet e nevojshme për të siguruar që çështja të përgatitet si duhet dhe sa më shpejt për gjykim.

8. Në bazë të nenit 39(13) të Ligjit dhe rregullës 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve të parashikuara në rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e fton Mbrojtjen të dorëzojë dosjen paraprake të çështjes brenda një afati të caktuar kohor.

9. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, Trupi Gjykues, *proprio motu*, ose pasi të tregohen arsye bindëse, mund ta shtyjë apo afrojë afatin e parashikuar në Rregullore apo të vendosur nga Trupi Gjykues.

10. Sipas rregullës 95(2)(f) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vendos për mocionet paraprake të paraqitura sipas rregullës 97 të Rregullores përpara kalimit të çështjes Trupit Gjykues.

11. Sipas rregullës 95(2)(j) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake cakton një datë të synuar që çështja të jetë gati për gjykim.

12. Sipas rregullës 98(1) të Rregullores, pas marrjes së parashtrimeve nga Prokurori i Specializuar dhe Mbrojtja sipas rregullës 95(4) dhe (5), dhe rregullës 97 të Rregullores, dhe brenda tridhjetë (30) ditësh nga vendimi përfundimtar mbi mocionet paraprake, Gjykatësja e Procedurës Paraprake i kalon Trupit Gjykues dosjen e plotë të çështjes.

¹³ KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 12 korrik 2024, f. 277, rreshtat 11-23.

III. DISKUTIM

A. DORËZIMI I DOSJEVE PARAPRAKE TË MBROJTJES

13. Gjykatësja e Procedurës Paraprake kujton se data për dorëzimin e dosjeve paraprake të Mbrojtjes është caktuar, sikundër u propozua nga z. Januzi,¹⁴ shtatë (7) ditë pas lëshimit të Vendimit për Konfirmimin e Ndryshimeve (pra, të hënën, 15 korrik 2024).¹⁵

14. Duke marrë parasysh afatin e afërt dhe faktin që Mbrojtja e Haxhi Shalës (“Mbrojtja e Shalës”), e cila po ashtu ka të drejtë të dorëzojë dosje paraprake, nuk ishte e pranishme për shkak të llojit të seancës, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vendos, *proprio motu*, të (i) anulojë të hënën, 15 korrik 2024, si datën e dorëzimit të dosjeve paraprake të Mbrojtjes; (ii) udhëzojë Mbrojtjen e Januzit të parashtojë kërkesën e vet për shtyrjen e afatit për dorëzimin e dosjes paraprake, ku të paraqesë arsyet për një kërkesë të tillë, deri të **hënën, 15 korrik 2024, në orën 16:00**; dhe (iii) udhëzojë Mbrojtjen e Bahtijarit, Mbrojtjen e Shalës dhe ZPS-në të dorëzojnë përgjigjet e tyre për kërkesën në fjalë, nëse dëshirojë, deri të **martën, 16 korrik 2024**. Gjykatësja e Procedurës Paraprake informon palët se nuk priten kundërpërgjigje dhe se vendimi për kërkesën e ardhshme të Mbrojtjes së Januzit do të jepet në kohën e duhur.

B. KALIMI I ÇËSHTJES TRUPIT GJYKUES

15. Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban parasysh synimin e deklaruar të Mbrojtjes së Januzit për të dorëzuar një mocion paraprak lidhur me akuzën e re që

¹⁴ Vendim i datës 20 qershor 2024, para. 8.

¹⁵ Vendim i datës 20 qershor 2024, para. 20(b).

përmban Aktakuza e Përbashkët.¹⁶ Rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se është e përshtatshme që të anulohet datën e kalimit të dosjes së çështjes Trupit Gjykues, e cila ishte vendosur të ishte katërmëdhjetë (14) ditë pas lëshimit të Vendimit për Konfirmimin e Ndryshimeve (pra, e hënë, 22 korrik 2024).¹⁷ Gjykatësja e Procedurës Paraprake informon palët se një datë e re do të caktohet në kohën e duhur.

IV. VENDIM

16. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- a) **ANULON** *proprio motu* datën e dorëzimit të dosjeve paraprake të mbrojtjes, sikur përcaktohet në paragrafin 14 të këtij vendimi;
- b) **UDHËZON** (i) Mbrojtjen e Januzit të paraqesë kërkesën e vet për shtyrjen e afatit të dorëzimit të dosjes së saj paraprake, duke paraqitur arsyet për një kërkesë të tillë, deri të **hënë, 15 korrik 2024, në orën 16:00**; dhe (ii) Mbrojtjen e Bahtijarit, Mbrojtjen e Shalës dhe ZPS-në të paraqesin përgjigjet e tyre ndaj saj, nëse dëshirojnë, deri të **martën, 16 korrik 2024**, sikundër përcaktohet në paragrafin 14 të këtij vendimi;
- c) **ANULON** datën për kalimin e dosjes së çështjes Trupit Gjykues, sikundër përcaktohet në paragrafin 15 të këtij vendimi; dhe
- d) **INFORMON** palët se data e re për kalimin e dosjes së çështjes Trupit Gjykues do të vendoset në kohën e duhur.

¹⁶ Shih më lart, para. 6.

¹⁷ Vendimi i 20 Qershorit 2024, para. 20(c).

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhori Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E premte, 12 korrik 2024

Në Hagë, Holandë.